



DREJTORIA E ARSIMIT

04 Nr. 600/01-27958

Data: 04.06.2025

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 08L-153 mbi Edukimin në fëmijërinë e hershme, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

KONKURS

Për regjistrimin e fëmijëve në Institucion Parashkollor publik në QEAP “Çerdhja”-Lipjan grup-moshat nga 1-6vjeç dhe paralelet e ndara fizike në Gadime; Sllovi; Shalë e Rufe i Ri në grup-moshat nga 1-5vjeç për Vitin Edukativ 2025/2026

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Vërtetim vendbanimi nga Bashkësia Lokale;
- Faturën e shërbimeve komunale, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë;
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Vërtetimi për vaksinimin e fëmijës sipas kalendarit të vaksinimit në përputhje me moshën i përcaktuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);
- Dëshminë që ka fëmijë të tjerë të regjistruar në institucionin parashkollor përkatës;

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucion parashkollorë:

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligji nr. 08L-153 mbi Edukimin në fëmijërinë e hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit:

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më: **04.06.2025 deri më datën 30.06.2025;**
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës **çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 12:00;**
- Shpallja e rezultateve bëhet **më datë: 03.07.2025** në institucionin parashkollorë përkatës;
- **Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen;**

Në: Lipjan

Më datë: 04.06.2025

Drejtori i DKA-së

Rasim Hasani

